

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA DURRËS**  
**KËSHILLI BASHKIAK**

**VENDIM**

Nr. 84, datë 29.07.2024

**PËR MIRATIMIN E NJË SHTESE NË NUMRIN E PUNONJËSVE TË APARATIT TË  
BASHKISË DURRËS**



Në zbatim të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligjit nr.68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e e vetëqeverisjes vendore”, Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, Vendimit nr. 435, datë 26.6.2024 “Për një shtesë në Vendimin nr. 867, datë 10.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për procedurat e bashkëpunimit në institucionet e administratës shtetërore”, si dhe sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Drejtoria e Buxhetit, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

**KËSHILLI BASHKIAK**  
**V E N D O S I :**

1. Miratimin e shtesës së numrit të punonjësve prej 20 (njëzetë) punonjësish në aparatit e Bashkisë Durrës në programin buxhetor me kod programi 01110 “Planifikim, menaxhim dhe administrim”, me qëllim ngritjen e Njesisë së Koordinimit të Procesit të Legalizimeve në Bashkinë Durrës.
2. Miratimin e nivelit të pagave të punonjësve të Njesisë së Koordinimit të Procesit të Legalizimeve të Bashkisë Durrës, si më poshtë vijon:

Emërtimi i pozicionit	Grupi i diplomës	Paga për pozicion
Drejtor Drejtorie	1	91.000 lekë
Përgjegjës sektori	1	80.300 lekë
Specialist	1 ose 2 ose 3	70.000 lekë

Grupi i diplomës	Niveli i kualifikimit sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK)	Vlera
1	Niveli 7 i KSHK	14,000 lekë
	Master i Shkencave, Master i arteve	
	Të barazvlefshme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë	
2	Niveli 7 i KSHK	12,000 lekë
	Master profesional	
	Të barazvlefshme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë	
3	Niveli 6 i KSHK	10,000 lekë

- Shtesa për vjetërsi në punë shtohet në masën 2 % përqind, pas çdo viti pune, deri në 25 vjet, dhe llogaritet mbi vlerën e shtesës së nivelit të kualifikimit.

- Efekti financiar për vitin 2024 për paga në vlerën 5,196,000 lekë dhe sigurime shoqërore në vlerën 868,000 lekë do të përballohen nga fondi rezervë i buxhetit të Bashkisë Durrës i planifikuar për vitin 2024.
- Ngarkohet Kryetari i Bashkisë të miratojë strukturën dhe organikën e Njësisë së Koordinimit të Procesit të Legalizimeve të Bashkisë Durrës.
- Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi, Drejtorja e Burimeve Njerëzore, Drejtorja e Buxhetit dhe Drejtorja Ekonomike.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

**KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK**

**Ani Dyrmishi**



**U shpall sot me datë 30.07.2024**




REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 446/prot.

Durrës, më 01.08.2024

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit



KËSHILLIT BASHKIAK  
DURRËS

KRYETARIT TË BASHKISË  
DURRËS

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.84 datë 29.07.2024 “Për miratimin e një shtese në numrin e punonjësve të aparatit të Bashkisë Durrës”.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” i ndryshuar, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

EMILJAN JANI

